

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krimetë Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Beqir Kalludra, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtaret profesioniste SH. Gërguri dhe Elife Uka, anëtare të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Mybera Latifi, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh. T., nga V., rr.‘...’ pn., për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par.3 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë–Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.949-11/2012 të dt.14.08.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurores së shtetit Besa Krajku, të akuzuarit Xh. T. dhe mbrojtësit av.O. M., sipas detyrës zyrtare, me dt.15.07.2016, mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Xh. T., nga i ati M. dhe nëna F., e vajzërisë P., i lindur më *data e lindjes...*, në V., ku edhe tani jeton, në rr.”...”pa nr., i shkurorëzuar, babë i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim qëndron prej dt.08.12.2011, e tutje.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

me dt.03.12.2012, rreth orës 07:30 min, në fshatin L. i E.-Lagjja e P., duke vepruar me dashje direkte e ka privuar nga jeta në mënyrë mizore të dëmtuarën, tani të ndjerën H. T., ashtu që i akuzuari me veturën e tij të tipit ‘Mercedes’, me targa *numri i targave...*, e ka marrë të ndjerën në lagjen e Gj., në V., së bashku janë nisur në P., gjatë rrugës ka filluar fjalosja në mes tyre, për shkak se tani i akuzuari ka kuptuar se e ndjera H. dëshiron t’i shkëpusë lidhjet e dashurisë me të njëjtin, dhe ka krijuar lidhje dashurie me një person tjetër, tani dëshmitarin S. H., dhe duke mos mund t’a përballojë këtë gjendje, i akuzuari Xh. me të arritur në fshatin Stanovc, shmang rrugën kryesore dhe vazhdon rrugën në drejtim të fshatit Brezhticë, dhe pasi arrinë në fshatin L. i E.-Lagjja e P., e ndal veturën, e nxjerrë nga vetura tani të ndjerën, dhe duke e mbajtur me dorën e majtë, me dorën e djathtë e nxjerrë një mjet të mprehtë-thikë dhe e qëllon disa herë me thikë të dëmtuarën tani të ndjerën, dhe atë në gjoks në anën e majtë, dhe në pjesën e epërme të majtë të shpinës, duke shprehë ndjenjat e tërbimit dhe hidhërimit të manifestuara me një gjendje të pandjeshmërisë ndaj tani të ndjerës, e lenë të ndjerën aty duke e ditur se e njëjta akoma është gjallë, mirëpo duke dashur që të njëjtës ti shkaktoj dhimbje dhe vuajtje të mëdha, ikë nga vendi ngjarjes, ndërkaq e ndjera nga plagët kishte vdekur në vendin e ngjarjes si pasojë e prerjes së muskullit të zemrës, mushkërisë së majtë, gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme, dhe e njëjta është gjetur e vdekur nga dy gjuetarë me dt.08.12.2012, në ora 12.58 minuta.

- me këtë ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par.3 nënpar. 3 të KPK-së.

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 34, 38, 64, 73 si dhe nenin 147 par.1 nënpar.3 të KPK-së, si dhe nenit 359, 365, 367, 368, 450, 453 dhe 463 par.2 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vjetësh, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.08.12.2011 e tutje.

Detyrohet i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 200 (dyqind) euro, brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit S. T. dhe G. T., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

Të akuzuarit Xh. T., i vazhdohet paraburgimi, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 367 par.6 dhe 7 të KPPK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë– Departamenti për Krimetë Rënda, me aktakuzën, PP.nr.949-11/2012 të dt.14.08.2013, eka akuzuar të akuzuarin Xh. T. nga V., për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par.3 të KPK-së.

Trupi gjykues i kësaj gjykate me aktgjykimin e dt. 16.12.2015 të akuzuarin Xh. T., e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par.3 të KPK-së, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 vjetësh. Gjykata e Apelit me rastin e shqyrtimit të ankesave të palëve në procedurë, e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me aktvendimin PAKR.nr.159/16 të dt. 04.04.2016, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë të kësaj gjykate, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar. 12 **lidhur me nenin 370 par.7 dhe 8** të KPPRK-së, dhe lëndën ia ka kthyer në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i akuzuari përsëri ka qëndruar pranë deklaratës së dhënë në gjykimin e parë, pra nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe meqë i akuzuari nuk e ka pranuar kryerjen e kësaj vepre penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar. 12 të KPPRK-së, për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar elementin qenësor të veprës penale, pra rrethanën mizore të kryerjes së veprës penale, kjo gjykatë, me pajtimin e plotë të palëve në procedurë, ka konstatuar të lexuara të gjitha dëshmitë dhe provat të administruara në gjykimin e parë, dhe ka vendosur që të dëgjohen edhe njëherë vetëm eksperti mjeko ligjor dhe ai psikiatrik, për sqarimin e rrethanave për dhimbjet e përjetuara fizike dhe psikike të tani të ndjerës, dhe mënyrën mizore të kryerjes së veprës penale nga i akuzuari.

Prokurorja e shtetit Besa Krajku në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, të dhënë në gjykimin e parë, ku ndër të tjera ka deklaruar se pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par.3 të KPK-së, ku edhe vet i akuzuari pjesërisht i ka pranuar veprimet inkriminuese, por jo edhe kualifikimin juridik të veprës penale. Prokurorja e shtetit ka bërë një përshkrim të shkurtër të mbrojtjes së të akuzuarit, i cili ka treguar rrjedhën e ngjarjes sipas verzionit të tij, duke kërkuar nga Gjykata, që mos t'ia falë besimin mbrojtjes së të akuzuarit, për faktin se një mbrojtje e tillë, është e drejtuar vetëm në shmangjen nga përgjegjësia penale e tij, dhe është në kundërshtim me të gjitha provat e administruara në shqyrtimet gjyqësore. Duke shtuar se nga provat e shqyrtuara, është vërtetuar këmbëngulësia e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale në mënyrë mizore, sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, përkatësisht braktisja e viktimës dhe lënja në atë gjendje në mal pas tërë atyre goditjeve, humbja e mjetit të kryerjes së veprës penale, kontaktimi me familjarët e viktimës me qëllim të vëzhgimit të situatës, duke qenë viktimë posaqërisht e pa mbrojtur dhe e ndjeshme, mjafton për të konkluduar se kjo vepër është kryer në mënyrë mizore, duke i shkaktuar viktimës vuajtje të stërgjatura, pasi që viktimë është gjetur pa shenja jete pas disa ditësh. Po ashtu, nga mendimi dhe

dëgjimi i ekspertëve të QKUK-së, është vërtetuar fakti se i akuzuari Xh. T. ka qenë i vetëdijshëm dhe i llogaritshëm në momentin e kryerjes së veprës penale, dhe në fund i propozon gjykatës, që i njëjti të shpallet fajtor, dhe t'i shqiptohet dënimi i merituar.

Për të dëmtuarit S. dhe G. T., meqenëse të njëjtit nuk kanë qenë prezent në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka vlerësuar se të njëjtit mbesin pranë deklaratës së dhënë në gjykimin e parë, ku kanë deklaruar se kërkojnë kompensim të dëmit, mirëpo me asnjë provë konkrete, nuk e kanë precizuar kërkesën e tyre.

I akuzuari Xh. T., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk dëshiron të deklaroj asgjë lidhur me këtë çështje, derisa në gjykimet paraprake, ndër të tjera ka deklaruar se rreth 7-8 muaj para ngjarjes kritike e ka njohur tani të ndjerën, me që i njëjti përveq si taksist, ka punuar edhe si moler dhe ka shkuar në shtëpinë e të njëjtës për të kryer punë të ndryshme, derisa e ndjera ka punuar në H., në ndërkohë kanë filluar lidhjet e dashurisë mes tyre, duke qenë taksist, disa herë në javë e ka shoqëruar deri në Prishtinë, po ashtu, edhe e ka pritur kur e ka përfunduar orarin e punës, dhe me të njëjtën ka pasë raporte të mira, edhe pse i njëjti e ka brakisur 5 - 6 ditë më parë, dhe, edhe pas braktisjes, e ndjera e ka ftuar për me dërgue në Prishtinë, se ka pas frikë se dikush po e përcjellë, duke e lutur “aman zaman se dikush po më përcjell”, dhe se, edhe ditën kritike i ka përcjellë një automjet me ngjyrë të zezë deri në vendin e ngjarjes, ashtu që gjatë udhëtimit për në Prishtinë, kanë filluar grindjet mes tyre për shkak të dyshimit të letrave që i janë dërguar në shtëpi të akuzuarit, dhe tani e ndjera me të arritur te udhëkryqi i fshatit Stanovc, ia ka kthyer timonin në drejtim të fsh Dumnicë e L., dhe kur kanë arritur në fsh. L., tani e ndjera ka kërkuar me dalë jashtë veture për nevoja fiziologjike, dhe pastaj ka rrëshqitë dhe ka ra poshtë, pastaj e ndjera e ka fyer duke iu drejtuar me fjalët “lahper, pis, më ka sha me nënë etj”, duke i thënë se “qitash ka me shkue te balldëska jote dhe ko mi tregu qishtu këtë gjendje si jam”, dhe pas këtyre fjalëve, i akuzuari e ka nxjerrë briskun nga rripi i brezit dhe e ka goditur 2 – 3 herë, briskun e ka lënë në vend të ngjarjes dhe dyshon se një person i cili i ka përcjellë dhe ka qenë diku rreth 5-6m. larg, e ka marrë atë brisk, ndërkaq e ndjera ka qenë akoma gjallë, e rrëzuar në gjunjë pas goditjeve me thikë, duke shpresue se ai person do t'i ndihmoj të ndjerës. Ndërkaq në fund e ka mbështetur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shpreh pendim për këtë veprë të cilën e ka kryer, dhe duke e lutur gjykatën që duke pasur për bazë të gjitha këto rrethana, të njëjtit t'ia shqiptoj një sanksion penal përkatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh. T. av.O. M., ka qëndruar pranë fjalës përfundimtare të dhënë në gjykimin e parë, ku ndër të tjera ka deklaruar, se pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij Xh. T. ka kryer veprën penale të Vrasjes së rëndë, nga neni 147 par.3 të KPK-së, siç e ngarkon dispozitivi i aktakuzës, sepse i mbrojturi i tij i ka pranuar veprimet inkriminuese se ka privuar nga jeta tani të ndjerën H. T., por nuk e ka pranuar cilësimin juridik të veprës penale sipas prokurorisë. Nuk është kontestuese se i mbrojturi i tij Xh. T. ka pasur raportet e mira me tani të ndjerën dhe familjen e saj, por nga deponimet e dëshmitarit S. H., është vërtetuar se tani e ndjera ka pasur raporte edhe me persona të tjerë, konsideron se i mbrojturi i tij veprën penale e ka kryer në gjendje të afektit mendor, pa fajin e tij, nga keqtrajtimi dhe fyerja e rëndë të cilën e ka pasur nga tani e ndjera H., sepse e njëjta i ka bërë presion në familje, duke i shkruar letra, të cilat i kanë rënë në duart e djalit dhe bashkshoertës së Xh. T., me të cilat e ka kërcënuar dhe shantazhuar, duke i thënë se ma ke shkatërruar jetën, kurse në ditën kritike derisa kanë qenë duke udhëtuar me veturë, e ndjera ia ka marrë timonin e veturës nga dora të akuzuarit, dhe e ka kthyer në drejtim të fshatit L. E., kur kanë arritur në vendin ku edhe është kryer vepra penale, në fjalosje e sipër me thikë e ka goditur në gjoks tani të ndjerën, të cilën nuk e dinë se sa herë e ka goditur, pasi që e ka humbur kontrollin nga sjelljet e tani të ndjerës. Duke u bazuar në mendimin e ekspertit të psikiatrisë dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, konsideron se i mbrojturi i tij në gjendje të afektit mendor ka kryer veprën penale nga neni 148 të KPK-së, dhe i propozon gjykatës, që të aplikohet neni 18 i KPRK-së, paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar, sepse i njëjti në vitin 2005 ka tentuar të bëj vetëvrasje, dhe se tani është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer. Dhe në fund ka shtuar se në këtë çështje penale, nuk janë vërtetuar elementet qenësore subjektive dhe objektive të kryerjes së kësaj vepre penale, duke shtuar më tutje se ky pretendim i mbrojtjes është vërtetuar edhe nga ekspertët psikiatrik dhe eksperti mjeko ligjor, i cili ka konstatuar se vdekja e tani të ndjerës ka pasuar brenda një

periudhe kohore prej gjashtë minutave, dhe se viktima nuk ka mund të përjetojë vuajtje të stërzgjatura dhe ekstreme nga këto goditje.

Pas procedimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga leximi i dëshmisë së të dëmtuarit S. T. të dhënë në prokurori dhe në shqyrtimin e parë gjyqësor, nga leximi i dëshmisë së dëshmitarëve G. T., S. H., B. V., S. A., si dhe është leximi i dëshmisë së dëshmitarëve G. T.1 dhe R. S., të dhëna në Prokurori, nga raporti i autopsisë i bërë me dt.10.12.2012 në Departamentin e Mjekësisë Ligjore zyra për ekzaminim ligjor eksperti mjeko ligjor dr.A. G., dhe nga Ekspertiza e përgaditur në Institutin e Psikiatrisë Forenzike nga ekspertët psikiatrik mjeko-ligjor dr. F. D. e dr. A. B., të dt.16.06.2014, dhe dëgjimi i të njëjtëve në seancë të shqyrtimit gjyqësor, të dëgjuar edhe në sencat e datës 20.05.2016 dhe 12.07.2016, nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes të dt.10.12.2012, fotoalbumit të vendit të ngjarjes, nga leximi i SMS-ve, nga raporti i ekzaminimit të veturës, nga raporti mbi bastisje në shtëpisë së të akuzuarit, nga raporti i QKUK-së–Klinika e Psikiatrisë i bërë me dt.16.06.2014, nga deklarimi i të akuzuarit Xh. T. i cili në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar veprimet inkriminuese, por nuk e ka pranuar kualifikimin juridik të veprës penale.

Nga leximi i dëshmisë së të dëmtuarit S. T., bashkëshortit të tani të ndjerës H., e dhënë në shqyrtimin e parë gjyqësor, për leximin e të cilës palët janë pajtuar paraprakisht, i cili ka deklaruar njëjtë edhe në prokurori, është vërtetuar se me tani të ndjerën H. T., kanë qenë në martesë 27 vite, pasi që nuk kanë pasur fëmijë për 10 vite martesë, e kanë adaptuar vajzën e cila tani është e moshës 17-vjeçare G. T.. Tani të akuzuarin Xh. T. e ka njohur, se ka punuar si taksist, por edhe si moler, dhe se e ka angazhuar që t'i kryejë punë të ndryshme në shtëpinë e tij. Njëherë bashkë me tani të ndjerën kanë shkuar në shtëpinë e tij, pasi djali i tij kishte dalur jashtë shtetit për t'i uruar rrugë të mbarë. Ditën kritike më dt.03.12.2011 tani e ndjera H. rreth orës 6:40 min., ka dalë nga shtëpia, për të shkuar në stacionin e autobusëve në Vushtrri, pasi që ka udhëtuar me autobus për në Prishtinë, sepse tani e ndjera ka punuar në H., si pastruese, në shtëpinë e M. B.. Më tutje ka shtuar se pasi e ndjera ka dalur nga shtëpia ka pasur nevojë që të pyes për diçka, e ka thirrë me telefon çdo 5-10 minuta, por telefonin e ka pasur të çkyqur, prapë nga puna i ka telefonuar, por telefoni ka qenë i mbyllur. Në ndërkohë, rreth orës 9:30-10:00 min., i akuzuari Xh. ka shkuar në lokal in e tij ku punon, ka qenë i shqetësuar dhe nervoz, por ka menduar se djali i ka shkuar jashtë shtetit dhe për atë është i shqetësuar, është munduar që t'a qetësojë dhe të njëjtën ditë, disa herë ka hyrë dhe ka dalë nga lokali i tij, por nuk ka dyshuar asgjë në të. Pasdite prapë e ka thirrë në telefon bashkëshortin e tij tani të ndjerën, telefoni ka qenë i mbyllur, kurse ajo zakonisht është kthyer në shtëpi në ora 18:00. Në mbrëmje rreth orës 19:00, vajza e tij G. i ka treguar pasi që e ka vendosur kartelën e valës në telefon, se i kanë shkruar SMS-të, nga telefoni i tani të ndjerës H., se gjëja është e kidnapuar në rrugën e Gjilanit nga një veturë ngjyrë hiri, e kanë mbyllur në banjo dhe dojnë me mbytë me thikë, ndonjë fjali tjetër nuk i kujtohet. Pas leximit të SMS-ve, së bashku me vajzën kanë shkuar në stacionin policor, e ka dhënë deklaratën në polici në cilësi të dyshuarit. Pas konsultave me policinë kanë dalur dhe e kanë kërkuar në drejtim të Gjilanit duke u bazuar në SMS-ët e ardhur nga telefoni i të ndjerës. Ditën e nesërme Xh. e ka takuar në kafe, në Vushtri, ka kërkuar që të shkojnë në vendin ku ka punuar tani e ndjera për të marr ndonjë informatë, së bashku me Xh. kanë shkuar te shtëpia e M. B. dhe i njëjti ju ka treguar, se tani e ndjera një ditë më parë, fare nuk ka qenë në punë. Ndërkaq, duke u kthyer nga H., Xh. i ka thënë se dy-tri herë e ka dërguar tani të ndjerën H. në H., aty ka filluar të dyshojë në të dhe prej asaj dite nuk e ka takuar më Xh., deri kur është gjetur kufoma e tani të ndjerës në L. E., pas 5 ditësh, ku edhe e ka kuptuar se Xh. e ka bërë vrasjen, ka shtuar se është e vërtetë se ka marr SMS-ët nga një numër i fshehtë, mirëpo nuk e njej personin me emrin R., kërkon kompensim të dëmit, kurse rreth pajtimit nga familja e Xh. nuk ka pasur ndonjë kërkesë, ashtu që tërë familjes së Xh. iu ka thënë se jeni të lirë, përveç të akuzuarit Xh..

Nga leximi i dëshmisë së të dëmtuares – dëshmitares G. T., vajza e tani të ndjerës, të dhënë në shqyrtimin e parë gjyqësor, e njëjta ka mbetur pranë deklaratave të cilat i ka dhënë në polici dhe në

prokurori, duke shtuar se Xh. T. e njej para shumë viteve, sepse jetojnë në të njejtën lagje, në shtëpinë e tyre Xh. ka punuar si moler disa herë, por ka pasur raste kur ka shkuar edhe si mysafir. Ditën kritike, tani e ndjera e ka pasur telefonin me vete, dhe SMS-ët i kanë ardhur nga telefoni i të ndjerës, ku ndër të tjera ka thënë se "më ka marrë njëfarë R. me thikë dhe me ka dërguar në drejtim kah Gjilani me një veturë Opel, ngjyrë hiri", dhe ka thënë "merre babin dhe hajdeni me një kerr me më marr se më ka shti me një banjo dhe kur kaloni ju këndeji unë e ndezi dhe e ndali dritën", por në SMS-ët nuk është i përshkuar vendi ku ka ndodhur rasti, nuk ka dëgjuar asnjëherë mamin se e ka përmendur emrin R., dhe nuk e dinë se kush është ai person. Para se me ndodh rasti, në shtëpi duke biseduar me nënën e saj, tani të ndjerën, ka vërejtur shenja nervoze, ndërsa një javë para ditës kritike, nëna i ka thënë se Xh. e ka kërcënuar me fjalë duke i thënë se 'kom me të mbytë ty dhe qikën'. Ajo nuk ia ka treguar arsyen, por edhe ajo nuk e ka pyetur për çfarë e ka kërcënuar. Një ditë pasi ka ndodhur vrasja e nënës së saj, e ka takuar Xh. afër shtëpisë, i cili i ka thënë "a po shkon me më ble cigare", të cilin shërbim ia ka kryer dhe nuk ka mundur me vërejt diçka te Xh.. Para se me u gjetë kufoma edhe njëherë derisa ka qenë me djalin e axhës, e ka takuar Xh., dhe i njëjti ka shkuar mbas 3-4 metra, ka ecur së bashku me ta, por nuk ka folur asgjë. Është e vërtetë, dy javë para se me ndodhë rasti kur nëna e saj, tani e ndjera H., ka shkuar në punë, ka qenë edhe kjo në veturë të cilën e ka drejtuar Xh., kur kanë arritur në hyrje të Prishtinës, Xh. me zë të lartë i është kërcënuar nënës së saj, e ka pyetur nënën se çfarë ishin ato kërcënime, por ajo nuk i ka treguar, ata kanë biseduar edhe për disa gjëra të tjera me nënën e saj, por nuk i kujtohen fjalët të cilët i kanë këmbyer, sepse nuk e ka kuptuar bisedën dhe nuk e ka ditur se për çfarë po bëhet fjalë.

Gjykata dëshmi e të dëmtuarëve S. dhe G. T., i vlerësoj si dëshmi bindëse, reale dhe objektive, e në përputhje njëra me tjetrën dhe me provat tjera të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga të cilat dëshmi, vërtetohet fakti se i akuzuari e ka shoqëruar shumë herë deri në vendin e punës në H., me veturën e tij tani të ndjerën, dhe po ashtu vërtetohet fakti se me të ndjerën kanë pasur mosmarrëveshje, grindje dhe kërcënime nga ana e të akuzuarit në drejtim të tani të ndjerës, e që më vonë këto fakte janë vërtetuar edhe nga dëshmitarë dhe prova materiale tjera.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit S. H. në shqyrtimin gjyqësor, gjithnjë me pajtimin e palëve në procedurë, nga e cila dëshmi është vërtetuar, se të ndjerën e ka njohur në një shitore në Mitrovicë, pronarin e të cilit tani e ndjera e kishte burrë të motrës, kanë biseduar me njëri tjetrin, dhe pas një kohe është takuar me të njejtën edhe në Vushtri. Më tutje ka shtuar se për aq sa e ka njohur, e ndjera ka qenë grua e ndershme dhe e urtë, por e njëjta i ka treguar se Xh. po sillet keq me te, se po frikësohet se i akuzuari po e kërcënon duke i thënë, se ka me ia mbytë vajzën, të cilat fjalë ia ka thënë 10 ditë para se me ndodhë rasti. Pastaj ka shtuar se të ndjerën kohëve të fundit e ka parë duke udhëtuar nga Vushtrria për në Prishtinë rregullisht me veturën e Xh., sepse në kohën kur ajo ka udhëtuar, ai ka zbrit prej autobusit sepse është kthyer nga puna, kurse Xh. ka qenë me veturë te stacioni i autobusëve. Dy ditë para se me ndodh rasti, tani e ndjera e ka thirrë në telefon dhe i ka thënë se Xh. është tranuar e ka thyer kartelën e vet të telefonit, se po i frikohet vetëm çikës e jo vetes, dhe se nuk e dinë arsyen se pse ka ardhur deri te kjo. Të ndjerës i ka thënë se pse nuk po e lajmëron rastin e kërcënimeve në polici, mirëpo e ndjera i ka thënë se është e brengosur vetëm për vajzën e saj, me tani të ndjerën ka biseduar kohëve të fundit shpesh me telefon, ajo është frikësuar vetëm për vajzën e saj dhe se ajo ka pasur një lidhje dashurie me të akuzuarin, pa dëshirën e saj. Dhe kur ky dëshmitar e ka pyetur tani të ndjerën, se pse po udhëton së bashku me Xh. pas kërcënimeve të cilat ajo i kishte treguar se i ka pasur nga Xh., ajo i është përgjigjur se po frikohet nga Xh. se ai ka me pre. Pasi që është zhdukur tani e ndjera, duke u bazuar në telefonatën të cilën dy ditë më parë e kishte pasur me H.n, në bazë të numrit të telefonit, policia e ka pyetur se mos ka njohuri se ku është tani e ndjera, policisë i ka thënë se nuk ka njohuri, se ajo ka pasur mosmarrëveshje me ndonjë person, përveç Xh.t, mbiemrin e të cilit nuk ia ka ditur, por e ka njohur vetëm si figurë. Edhe dëshminë e këtij dëshmitari, gjykata e ka vlerësue si dëshmi objektive dhe reale, e cila dëshmi përputhet në tërësi me provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht sms-ve dhe regjistrimit të bisedave të zhvilluara në mes të tani të akuzuarit me tani të ndjerën, dhe në mes të këtij dëshmitari me të ndjerën, ku vërtetohet pa kontestueshëm ky fakt, se vërtetë ka pasë mosmarrëveshje dhe kërcënime nga i akuzuari në drejtim të dëmtuarës, dhe se ka ekzistuar edhe një lidhje dashurie në mes të këtij dëshmitari dhe tani të ndjerës.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarëve B. V. dhe S. A. të dhëna gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor, gjithnjë me pajtimin e palëve në procedurë, dëshmia e të cilëve është e njëjtë, është vërtetuar, se ditën kritike në fshatin L.i E., kah ora 10:00, duke u kthyer nga gjahu, në një rrugë të fshatit që e lidhë fshatin L.me magjistralen Prishtinë-Podujevë, ka qenë një përrua dhe afër përronit, në një rrugë të këmbësorëve, e kanë parë një figurë që iu është dukur si kukullë, kur janë afruar 3-4 metra, kanë parë se është trupi i një femre, e shtrirë në përrua, nuk kanë vërejtur plagë sepse nuk kanë qenë afër saj, por e ndjera sipas të njëjtëve ka qenë e veshur, e mbuluar me borë, e pastaj menjëherë e kanë lajmëruar Policinë e Kosovës. Gjykata edhe këto dëshmi i ka vlerësuar si dëshmi reale dhe në përputhje me provat tjera materiale përkatësisht raportin e Njësisë së Forenzikës dhe fotodokumentacionin që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitares G. T.1, bashkëshortes së të akuzuarit, e dhënë në Prokurori me dt.15.02.2013, e cila dëshmi me pëlqimin e palëve në procedurë është lexuar edhe në shqyrtimin e parë gjyqësor, e cila ka deklaruar se me të akuzuarin Xh. T. ka qenë e martuar për 10 vite, ai më parë ka qenë i martuar edhe katër herë tjera, kjo ka qenë gruaja e pestë, dhe nga martesat e mëparshme Xh. ka një djalë të moshës 29-vjeçare, i cili jeton në Gjermani. Xh. në vitin 2012 ka filluar të punojë si taksist, gjatë kohës sa ka qenë e martuar me Xh.n, raportet e tyre kanë qenë të mira, në muajin e fundit Xh. ka pasur shqetësime, por ka menduar se i ka për shkak të djalit të tij që kishte shkuar jashtë për të jetuar. Tani të ndjerën e ka njohur edhe më parë, dhe atë njëherë së bashku me burrin e saj S. kanë ardhur në shtëpinë e tyre në muajin nëntor të vitit 2012, për t'a përcjellë djalin e Xh.t, i cili shkonte jashtë Kosovës, kurse 6 muaj më parë me Xh.n ka qenë njëherë për të vizituar nënën e S., sepse Xh. dhe S. kanë qenë shokë nga fëmijëria, kanë jetuar në një mahallë, por më vonë ajo me Xh.n kanë jetuar në banesë. Xh. ka punuar si taksist ka dalë heret nga shtëpia, është kthyer në mbrëmje. Xh. ka qenë i brengosur kohëve të fundit, por i ka ardhur keq që të pyet, njëherë Xh. i ka thënë se kishte gjetur një letër para dverve të banesës, atë letër e ka mbajtur në dorë dhe i ka thënë "shih se çka po shkruan" se gjoja ai po e tradhëton me gruan e shokut – S.. Në atë letër nuk e dinë se çka ka shkruar sepse nuk e ka parë vetë, kurse letrat tjera nuk i ka parë, nuk ka dyshuar se Xh. është duke e tradhëtuar, sepse kishin kushte të vështira, luftonin për ekzistencë dhe nuk brengosej për gjëra të tjera. I kujtohet kur Xh. i ka thënë se i ka hupur gruaja S. dhe pas tri ditëve ka shkuar me dhënë deklaratë në polici, kurse me dt.08.12.2012 e kanë marrë policia nga shtëpia. Sa e dinë ajo Xh. nuk ka pasur armë, nuk ka qenë agresiv, por nuk e dinë se si është sjellë jashtë shtëpisë, pas këtij rasti ajo çelësat e banesës ia ka dorëzuar motrës së Xh.t, ka qenë e shqetësuar nga rasti dhe më nuk do të jetoj në atë shtëpi, lidhur me veprën penale të cilën e ka kryer Xh. është njoftuar nga motra e Xh.t.

Gjykata ka bërë vlerësimin e dëshmisë së dëshmitares G. T.1 dhe gjeti se kjo dëshmi ishte reale, pa kundërtënie, e qartë, se në mënyrë precize i ka përshkruar veprimet e të akuzuarit para se me kryer veprën penale dhe shqetësimet të cilat i ka vërejtuar te ai, kurse sa i përket letrës që pretendon i akuzuari, se tani e ndjera i ka shkruar disa herë dhe një nga këto letra e ka marrë edhe gruaja e tij G., kjo dëshmitare ka sqaruar se atë letër nuk e ka lexuar fare, nuk e dinë përmbajtjen, vetëm se i ka thënë Xh. se çka ka shkruar në atë letër, se letra tjera nuk ka dëgjuar dhe nuk ka parë se Xh. apo djali ka pranuar, se nuk e ka shqetësuar fare ajo letër, po ashtu ka theksuar se Xh. në shtëpi nuk ka qenë agresiv, e çka ka bërë jashtë shtëpisë nuk e dinë. Pra, kjo dëshmi e kundërshton në tërësi pretendimin e mbrojtjes së të akuzuarit, se ka pranuar shumë letra nga e akuzuara, dhe se këto letra kanë shkaktuar çrregullim serioz në raportet bashkëshortore të tyre.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit R. S. e dhënë në Prokurori me dt.11.07.2013, është vërtetuar se tani të ndjerën H. T. e ka njohur, sepse si vozitës i autobusit e ka mbajtur linjën Prishtinë – Gjiilan, dhe e njehta shpesh ka udhëtuar me autobusin e tyre, nga H. deri te Stacioni i Autobusëve në Prishtinë, në shoqëri ka qenë së bashku me 5 - 6 shoqe, të cilat udhëtonin së bashku, e kjo ka ndodhur para 6 viteve, se më nuk ka punuar si vozitës, tani të ndjerën nuk e ka takuar asnjëherë. Një personi para 4 viteve i ka pasur hua një shumë të hollash dhe gabimisht ka thirrur në telefonin fikse në shtëpinë e bashkëshortit të H. T., sepse në numrin të cilin ka thirrë, çdoherë ia kanë mbyllur telefonin dhe ka menduar se po thirrë gabimisht, me tani të ndjerën nuk ka pasur asgjë private, nuk ka komunikuar asnjëherë me te dhe nuk ka njohuri asgjë për jetën e saj private, nuk e ka të qartë se si dikush ka mundur me shkruar SMS prej telefonit të saj në emrin e tij, sepse nuk e ka njohur tani të akuzuarin

Xh. T.. Gjykata ka bërë vlerësimin e dëshmisë së dëshmitarit R. S., dhe ka konstatuar se kjo dëshmi, nuk ka qenë relevante në këtë çështje penale fare.

Nga raporti i Njesisë së Forenzikës në Prishtinë, i dt.08.12.2012, është vërtetuar se me dt.08.12.2012, në orën 12:58, në fshatin L. i E., në lagjen e P., është gjetur trupi i pajetë i tani të ndjerës H., nga gjuetarët të cilët e kanë lajmëruar rastin. Të njëjtën datë rreth orës 21:00 deri në orën 22:00, është bërë kontrollimi i banesës së Xh. T. në rr.'...' në V., kur dhe është arrestuar i akuzuari Xh. T.. Njësia e krim-teknikës në vendin e ngjarjes, kanë shkuar së bashku me të akuzuarin Xh. T., me dt.09.12.2012, është bërë kontrollimi i vendit të ngjarjes me detektor 'GARRET CSI 250' dhe me mjete tjera ndihmëse, lopata dhe grabuja, por nuk është gjetur mjete me të cilin dyshohet se është kryer vepra, sepse toka ka qenë e mbuluar me një shtres të borës.

Nga fotoalbumi i bërë nga njësia e Forenzikës, vendi i krimit ku tani e ndjera është gjetur, është vërtetuar se aty afër ka qenë një lumi, mal, i mbuluar me bore, dhe po ashtu vërtetohet fakti se e ndjera në atë vend edhe ka ndërruar jetë, pas plagëve të pësuarra me thikë nga tani i akuzuari.

Nga raporti i autopsisë i përpiluar me dt.10.12.2012 i kryer në Departamentin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, pjesëmarrës në autopsi ka qenë eksperti mjeko-ligjor dr.A. G., tekniku A. H. dhe fotografi B. R., kurse Sh. B. nga njësia e Forenzikës është marrë me mbledhjen e shënimeve për përpilimin e raportit, të cilët kanë konstatuar se trupi i pa jetë, i tani të ndjerës, ka qenë i mbështjellur në qese të najllonit, është evidentuar me A12-308, tani e ndjera në pjesën e epërme ka pasur të veshur një trenerkë me kapelë, ngjyrë të zezë, me pulla, trenerka ka qenë e hapur, në pjesën e majtë të trenerkës kanë qenë 8 dëmtime të shkaktuara me mjete të forta me maje dhe teh, një fanellë me krihë të gjatë me ngjyra të kombinuara kaltër dhe krem, në anën e majtë të përparme kishte 8 dëmtime me mjete të forta me maje thikë. Në pjesën e poshtme të trupit ka pasur veshur gjinse të kaltërta. Lëndimet janë evidentuar në fytyrë, në pjesën e majtë të përparme të gjoksit, nën sqetull, në dorën e majtë, kurse detajet tjera i paraqet raporti i ekspertit mjeko-ligjor.

Sipas raportit të autopsisë i bërë nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore, nga eksperti mjeko-ligjor dr.A. G., me dt.10.12.2014, është vërtetuar se vdekja e tani të ndjerës H. T. ka ardhur si pasojë e prerjes së muskulit të zembrës, mushkërisë së majtë, gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme, të cilat lëndime janë marrë nga goditjet e shumta, me mjet i cili posedon maje dhe teh (thikë). Ndërkaq, me rastin e dhënjes së dëshmisë në cilësinë e ekspertit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Dr. A. G. ka deklaruar se pas kryerjes së autopsisë së të ndjerës, janë gjetur 23 dëmtime trupore, të cilat dëmtime korrespondojnë plotësisht me dëmtimet e gjetura në rrobat e viktimës, prej këtyre dëmtimeve, 19 dëmtime janë të shkaktuara nga mjete i cili posedon maje dhe teh, të shkaktuara në regionin e gjoksit të majtë, nën sqetull dhe në pjesën e pasme të epërme të shpinës, prej tyre 12 dëmtime janë të natyrës së dëmtimit të rëndë trupor, me nr. 1,2,5,6,7,9,10,13,14,15,17, dhe 18, dëmtime të cilat përveq se kanë kaluar murin e kafazit të krahërorit, kanë prekur edhe cipat mbështjellëse të mushkërive dhe vet mushkëritë, derisa dëmtimi i përshkruar në pikën 18 ka qenë fatal, sepse ka prekur edhe muskulin e zembrës dhe ka krijuar komunikim mes hapësirave të komorave të zembrës dhe ambientit jashtë zembrës. Mirëpo ka shtuar se si ekspert nuk mund t'a konstatoj radhën e plagëve të shkaktuara se cila ka qenë plaga e parë e pastaj tjetra, duke shtuar se edhe po të mos e kishte marrë goditjen në muskulin e zembrës, e ndjera nuk do të mund t'i mbijetonte edhe 11 lëndime të natyrës së rëndë trupore, të cilat i kanë prekur organet vitale të organizmit siq janë mushkëritë, dhe si pasojë e depërtimit të mjetit me maje në mushkëri, në mushkëri ka depërtuar ajri, kurse nga brenda është lëshuar edhe gjaku, dhe është krijuar e ashtëquajtura hematomotoras në kafazin e krahërorit, e që kjo përveç që shkakton humbjen e gjakut që del prej mushkërive, shkakton edhe presion në organet vitale të kafazit të krahërorit – mushkërive si pasojë e depërtimit të ajrit dhe liritimit të gjakut në hapësirat e mushkërive dhe kafazit të krahërorit. Më tutje ka shtuar se 7 plagët tjera, gjithashtu janë shkaktuar nga mjete me maje dhe teh, dhe atë plagët me nr. 3,4,8,11,12,16 dhe 19, e të cilat janë të natyrës së lëndimit të lehtë trupor, për shkak se mjete goditës, nuk ka depërtuar deri te hapësira e kafazit të krahërorit për shkak të rezistencës së rrugëtimit të goditjes, nga se ka qenë pjesa kockore e brinjëve, dhe dëmtimi në kokë ku vetëm pjesa e butë është prekur, kurse kafka nuk ka lejuar të depërtoj më thellë. Ndërkaq lëndimet tjera dhe atë në fotografitë e fotoalbumit me nr. 20, janë përshkruar disa gërvishje – prerje të

gishtërinjëve të dorës së majtë që kualifikohen si plagë rezistente gjatë mbrojtjes, ndërsa plagët 22 dhe 23 janë gjakmbledhje nënlëkurore në mollëzen e fytyrës dhe në sipërfaqen e jashtme të krahit të majtë, që janë si pasojë e goditjes me mjet të fortë mbretës. Sa i përket kohëzgjatjes së shkaktimit të vdekjes së të ndjerës, ka deklaruar se pai që i është prerë muskuli i zemrës, e ndjera ka mund të jetoj disa minuta, sepse ka filluar humbja e një sasive të gjakut, dhe humbja e një të tretës së sasisë së gjakut, kalon në rrezikshmëri për jetën, dhe në këto momente ajo kalon në disa faza të para vdekjes, të humbjes së vetëdijës, komës së trurit, agonia dhe faza e vdekjes, e që krejt ky proces mund të zgjasë disa minuta përafërsisht 5 – 6 minuta. Ndërkaq në rigjykimi, seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.05.2016, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në gjykimin e parë të datës 20.05.2015, duke shtuar në përgjigjen e mbrojtësit të të akuzuarit, se nëse edhe nëse goditja e parë, do t'ishite goditje vdekjeprurëse dhe nëse do t'ishite e vetmja goditje, procesi i vdekjes mund të kishte zgjatur deri në gjysmë ore, varësisht prej organizmit të njeriut sepse organizmi i njeriut kur pëson plagë të brendshme, vetë organet e kafazit të kraharorit i bëjnë rezistencë plagës, dhe nuk e lejojnë që presioni arterial me rrjedhë gjak aq shumë, sa ato që janë shumë afër me ambientin e jashtëm, duke e elaboruar me një shembull siç mund të jetë rasti te prerja e arteries karotide në qafë, e cila gjendet menjëherë nën lëkurë, dhe derdhja e gjakut nga kjo arterie pa presion del shpejt se s'ka rezistencë nga jashtë, dhe një rrjedhje e tillë e gjakut është më e shpejtë dhe kjo rrjedhje e gjakut mund të shkaktoj vdekje prej 60-90 sekonda, duke shtuar më tutje se edhe pasi që është prerë muskuli i zemrës i tani të ndjerës, e ndjera ka mund të ndiej dhimbje.

Sipas raportit të psikiatrisë të pëpiluar nga Instituti i Psikatriisë Forenzike në QKUK, nga ekspertët psikiatrik mjeko-ligjor dr.F. D. e dr.A. B., të dt.16.06.2014, dhe me rastin e dëgjimit në cilësinë e ekspertit psikiatrik në seancën e shqyrtimit gjyqësor, dr.A. B., më dt.19.09.2014, është konstatuar se i akuzuari Xh. T., gjatë qëndrimit në Klinikën Psikiatrike nga dt.06.05.2014 deri me dt.16.06.2014, është trajtuar nga ekipi i ekspertëve dr.F. D. dhe dr.A. B.. Sipas të dhënave të historisë së të akuzuarit, ai që në moshën adoleshente ka manifestuar sjellje antisociale, ka qëndruar në burg për të mitur, është martuar 5 herë, nga të gjitha këto vërtetohet se i njëjti ka pasur çrregullime të personalitetit antisocial, **në vitin 2005 ka tentuar të bëjë vetëvrasje**, por këto karakteristika të çrregullimit të personalitetit me kohë janë zbehur dhe zvogëluar në intensitet, dhe edhe në bazë të literaturës shkencore, konsiderohet se ka çrregullime të personalitetit, sëmundje kjo mendore me karakter të përhershëm, por në 10 vitet e fundit ka pasur një stabilitet relativ në vazhdimësi, nuk është konstatuar ndonjë sëmundje tjetër, siç janë ngecjet mendore dhe format tjera të rënda të çrregullimeve mendore. Ditën kritike bazuar në të dhënat e deponuara në shkresat e lëndës dhe të dhënave anamnestike, karakteristikave të personalitetit të tij, kanë konstatuar se i akuzuari Xh. ka pasur të zvogëluar në llogaritshmëri, por jo deri në atë masë esenciale, ka pasur llogaritshmëri për veprën penale të cilën e ka kryer, dhe i njëjti mund të marrë pjesë në seancat gjyqësore, gjatë qëndrimit të tij në klinikë, nuk janë shfaqur psikosimptomatologji e cila nuk mund të kontrollohet, përveç mërziqjes, ankthit, pagjumësisë, pendimit për veprën të cilën e ka kryer dhe për shkak të rrethanave në të cilat tani gjendet. Po ashtu, edhe eksperti psikiatrik dr.F. D., në seancën e shqyrtimit gjyqësor në rigjykim të datës 19.10.2015, ka deklaruar në mënyrë të ngjashme sikurse edhe kolegu i tij, dr.A. B. duke shtuar se te i akuzuari është konstatuar llogaritshmëri e zvogëluar e kontrollimit të veprimeve të tij, mirëpo jo esencialisht e zvogëluar, po ashtu ka konstatuar faktin se në ekspertizë është konstatuar mendimi se i njëjti ka çrregullime të personalitetit, mirëpo edhe është dhënë konstatimi se i njëjti gjatë dhjetë viteve të fundit, ka pas një stabilitet relativ të personalitetit psikik të tij, e deri te ky konstatim ka ardhë duke u bazuar në disa karakteristika të personalitetit të të akuzuarit, ku i akuzuari ka pas një bashkëpunim jashtëzakonisht në nivel gjatë ekzaminimit psikiatrik, i akuzuari ka shpreh pendim të thellë për veprimet e tij, dmth., se edhe këto fakte flasin se te i njëjti është një gjendje më stabile, andaj bazuar edhe në mendimin teorik shkencor dhe gjendjen e konstatuar me rastin e ekzaminimit psikiatrik të të akuzuarit, kanë arritur në një përfundim, se i njëjti ka pasur një stabilitet relativ psikik. Po ashtu në pyetjen e prokurorit se a ka ndier kënaqësi i akuzuari gjatë shkaktimit të lëndimeve të tani të ndjerës, eksperti është përgjigjur se bazuar në mendimin dhe konstatimin e dhënë në ekspertizë, te i akuzuari, veprimet e drejtuara viktimës nuk kanë krijuar kënaqësi. Ndërkaq në seancën e shqyrtimit gjyqësor në rigjykim më datë 20.05.2016, eksperti psikiatrik dr.F. D. ka përshkruar përjetimin e dhimbjeve të tani të ndjerës gjatë dhe pas goditjeve me thikë nga tani i akuzuari, duke shtuar se viktimja ka përjetuar dhimbje shpirtërore dhe ate fillimisht në një gjendje të stresit të rëndë me ankth, frikë, ndrojtje,

emocioni i frikës ka qenë i vërtetë sepse e njëjta e ka pa rrezikun me sytë e saj, kështu që ka ardh në një gjendje emocionale më të rëndë dhe ka përjetuar dhimbje shpirtërore, të cilat kanë filluar me intensitet mesatar deri në bindjen se ngjarja po determinohet keq, edhe dhimbje të intensitetit të lartë deri në humbjen e vetëdijes. Ndërkaq sa i përket gjendjes emocionale të të akuzuarit gjatë dhe pas goditjeve me thikë të ndjerën, eksperti ka deklaruar se i akuzuari ka qenë në një gjendje mjaftë emocionale të llahtarshme shpirtërore, gjendje stresante në mënyrë intensive, pikëlluese, duke marrë për bazë numrin e madh të goditjeve, kjo ka shkaktuar në çdo goditje përgjigje emocionale mjaft të dhimbshme për kryerësin, duke vazhduar më tutje se i akuzuari ka pasë karakteristikat e personalitetit antisocial siç është e përshkruar në pikën A fq.8 të ekspertizës, karakteristika këto dhe situata në tërësi nuk kanë bërë që i njëjti të ndihet duke vuajtur ose duke pasur kënaqësi, sepse kjo karakteristikë e personalitetit e zhveshë prej vuajtjeve shpirtërore, dhe meqenëse ngjarja është zhvilluar shpejtë eksperti vlerëson se i akuzuari nuk ka pas ndjenja ose emocione sadiste duke shtuar se sadistin e kënaqin veprimet që shkaktojnë vdekjen e ngadalshme. Sa i përket elementit objektiv të veprës penale, gjykata e ka vlerësuar dhe aprovuar mendimin e ekspertit, pra faktin se tani e ndjera, ka përjetuar frikë të vërtetë, sepse e njëjta e ka pa rrezikun me sytë e saj, kështu që ka ardhë në një gjendje emocionale më të rëndë dhe ka përjetuar dhimbje shpirtërore të cilat kanë filluar me intensitet mesatar deri në bindjen se ngjarja po determinohet keq, edhe dhimbje të intensitetit të lartë deri në humbjen e vetëdijes. Ndërkaq, sa i përket elementit subjektiv të veprës penale, eksperti ka dhënë dëshmi kundërthënëse lidhur me të gjeturat dhe konstatimet e tij, me ç'rast kryetari i trupit gjykues ka qenë i detyruar që ta ballafaqojë me këto deklarata kundërthënëse, dhe në pyetjen se si është e mundur që në një përgjigje deklaroi se i akuzuari gjatë ndërmarrjes së këtyre veprimeve ka përjetuar dhimbje të mëdha shpirtërore, derisa në pyetjen vijuese deklaroi se i akuzuari nuk ka ndier vuajtje apo kënaqësi gjatë ndërmarrjes së këtyre veprimeve, eksperti është përgjigjur me arsyetimin se "kjo tingëllon si përgjigje të kundërta, mirëpo përgjigja në pyetjen e parë se i njëjti ka përjetuar dhimbje shpirtërore është dhënë në kuadër të kapacitetit të tij mendor, duke llogaritur çrregullimin e përhershëm mendor, mirëpo nuk e kanë prekur nivelin e përjetimit të tij të kënaqësisë apo vuajtjeve në dhimbjet e viktimës. Dhe në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues që eksperti të deklarohet edhe njëherë lidhur me shkallën e përgjegjësisë i njëjti përgjigjet se shkalla e përgjegjësisë nuk ndërron siç është konstatuar nga ekipi mjekësor me rastin e ekzaminimit psikiatrik të akuzuarit dhe se llogaritshmëria e të akuzuarit përkundër faktit që i njëjti ka ndier dhimbje shpirtërore dhe nuk ka pas elemente sadiste duke llogaritur nga karakteristikat që dalin nga sëmundja e tij, ka çuar deri te konstatimi i ekspertëve se llogaritshmëria ka qenë i zvogëluar por jo esencial. Dhe në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se me rastin e vlerësimit që e ka dhënë në ekspertizë në këtë llogaritshmëri të zvogëluar, a janë bazuar në vlerësimin se te i akuzuari është konstatuar sëmundja me karakter të përhershëm, apo me vlerësimin se në 10 vitet e fundit i akuzuari ka pasur një stabilitet relativ psikik, eksperti ka deklaruar se në bazë të të gjitha karakteristikave të personalitetit të tij, dinamikës së veprës nga të dhënat e deponuara në shkresat e lëndës dhe nga praktika mjekësore, brishtësia dhe gjendja e tij labile në 10 vitet e fundit është përshkruar me fjalët se ka pas një stabilitet relativ, që nënkupton se ka mund të ketë edhe shpërthime të vogla të cilat edhe e kanë çuar në veprimet antisociale. Dhe në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues, se a i konsideron eksperti goditjet 17 herë me thikë, si shpërthime të vogla të personalitetit, eksperti është përgjigjur se te karakteristikat e personalitetit antisocial, acarimet dhe keqësimet, shpërthimet fillojnë me intensitet të ulët dhe varësisht nga faktorët e ndryshëm determinojnë ose përfundojnë edhe me veprime të rënda, siç është vepruar në rastin konkret. Trupi gjykues këtë dëshmi të ekspertit lidhur me elementin subjektiv, e ka vlerësuar si dëshmi kundërthënëse për faktin se eksperti për të njëjtën pyetje, njëherë është përgjigjur se i akuzuari ka përjetuar dhimbje shpirtërore, derisa në përgjigjen e dytë ka deklaruar se nuk ka ndier kurrfarë dhimbje dhe as kënaqësi me rastin e ndërmarrjes së këtyre veprimeve. Dhe meqenëse dëshmia e ekspertit ka qenë kundërthënëse trupi gjykues, ka vendosur që në seancën e radhës ta ftoj edhe ekspertin tjetër dr.A. B., psikiatër i cili në seancën e dt.12.07.2016 ndër të tjera ka deklaruar se sa i përket intensitetit dhe shkallës së dhimbjeve dhe vuajtjeve psikike të të ndjerës, nuk mund të deklarohet pasi që e njëjta nuk ka qenë objekt i shqyrtimit të ekspertizës, ndërkaq lidhur me gjendjen psikike të të akuzuarit gjatë ndërmarrjes së veprimeve goditëse ka deklaruar se me rastin e ndërmarrjes së këtyre veprimeve nga i akuzuari, ndjenjat e tij kanë qenë shqetësim, hidhërim, brengosje dhe se duke pas për bazë karakteristikat e personalitetit të të akuzuarit pra një personaliteti antisocial në këta persona kanë një prag frustrativ në shkallë të ngacmueshmërisë, hidhërimit,

shqetësimit, të manifestimit të agresivitetit të një shkalle më të ulët se personat e tjerë që nuk e kanë këtë çrregullim dhe me rastin e një konflikti verbal brenga dhe shqetësimi të akuzuarit kanë ardhur shumë shpejt dhe lehtë në shprehje. Ndërkaq sa i përket përgjegjëshmërisë së akuzuarit i njëjti ka qëndruar pranë mendimit të dhënë në ekspertizë, pra të përgjegjësisë së zvogëluar por jo esenciale e që deri të ky konstatim kanë ardhur duke pas për bazë strukturën e personalitetit të tij, kohëzgjatjen e ekzaminimit prej afër 40 ditëve në bazë të dokumentacionit mjekësor të sjellur nga familjarët, në bazë të shënimeve heteroanamnestike të siguruara nga motra e të akuzuarit, në bazë të sjelljeve të tij në 10 vitet e fundit i cili ka pas një stabilitet relativ dhe në bazë të literaturës shkencore. Ndërkaq sa i përket raportit të akuzuarit në lidhje me viktimën me rastin e ndërmarrjes së veprimeve, përkatësisht goditjeve me thikë se si ka qenë gjendja emocionale e tij, eksperti është përgjigjur se gjatë goditjes me thikë i njëjti ka shfaqë ndjenja të tërbimit dhe hidhërimit të manifestuara me ndjenjën e pandjeshmërisë së vuajtjes së viktimës, përndryshe po të kishte pas ndjenja do të kishte ndër kënaqësi me rastin e ndërmarrjes së këtyre veprimeve. Gjykata e ka vlerësuar dëshminë e këtij eksperti të cilën dëshmi e ka vlerësuar si dëshmi objektive, reale, andaj edhe me rastin e marrjes së vendimit gjyqësor të njëjtin e ka bazuar në këtë provë. Kjo për faktin se nga të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe veprimet e përshkruara të cilat i ka ndërmarrë i akuzuari siç ka deklaruar edhe vetë në polici me rastin e dhënies së deklaratës së parë pas kësaj ngjarje, gjykata ka vërtetuar me bindje të plotë se për shkak të raporteve të përkeqësuar me tani të ndjerën, ka planifikuar kryerjen e kësaj veprë penale, duke shkuar në vendin ku edhe është kryer kjo veprë, duke vepruar në mënyrë mizore, siç edhe vetë ka deklaruar e ka nxjerrë viktimën nga automjeti, me dorën e majtë e ka mbajtur derisa me dorën e djathtë e ka goditur me thikë në gjoks, dhe nga kjo kronologji e veprimeve të ndërmarra, gjykata e mbështetë deklaratën e ekspertit dr.A. B. psikiatër, se vërtetë i akuzuari nuk ka manifestuar ndjeshmërinë e vuajtjeve të viktimës.

Nga raporti i ekzaminimit të veturës, nga njësia e Forenzikës të dt.17.12.2012, i bërë nga hetuesi F. K., me të cilën veturë akuzuari të ndjerën e kishte dërguar në vendin e krimit, është evidentuar vetura 'Mercedes' 240 D, ngjyrë e gjelbër, me targa *numri i targave...*, me reklamë 'Taksi', është bërë fotografimi i veturës për kërkimin e gjurmëve latent të gishtërinjve në vendet e mundshme, mostrat janë marrë në të gjitha pjesët e veturës, por rezultati ka qenë negativ.

Objekt shqyrtimi për gjykatën, kanë qenë edhe SMS-ët e dërguara nga i akuzuari Xh. T. nga telefoni i tani të ndjerës H. T. në telefonin e vajzës së të ndjerës G., SMS-ët tjera dhe thirrjet telefonike.

Nga përmbajtja e SMS-ve, vërtetohet se me dt.03.12.2012, i akuzuari Xh. i ka shkruar vajzës së tani të ndjerës G. SMS-a, me këtë përmbajtje: 'G. qika nanës më ka marr S. R. po don me myt mu me thikë thirre babin kallzoi të merr një kerr le të vjen kah Gjilani por jo policinë'. Mesazhi tjetër me këtë përmbajtje: 'G. më ka shti një shtëpi te asfalti kallzoi babin një opel ngjyrë hiri shpejt', mesazhi tjetër me këtë përmbajtje: 'G. në nevojto më ka mshel unë po e shoh rrugën hajdeni me kerr unë i dhezi dritat shpejt thirre babin e jo policinë'.

Po ashtu gjykata i ka vlerësuar edhe thirrjet telefonike në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës, nga të cilat thirrje, rezulton se nga nr. i tel. mobil *numri i telefonit...*, të cilin e ka shfrytëzuar i akuzuari, në periudhën kohore prej dt. 26.11.2012 deri më datën 01.12.2012, e ka thirrë më se 78 herë në telefon mobil të ndjerës H. T. në nr. *numri i telefonit...*, derisa e ndjera H., brenda të njëjtës periudhë kohore i ka telefonuar të akuzuarit 21 herë. Ndërkaq, e ndjera H. nga nr. i tel. *numri i telefonit...*, në periudhën kohore prej dat. 26.11.2012 deri më datën 03.12.2012, i ka telefonuar më se 54 herë në telefon mobil dëshmitarit S. H. në nr. *numri i telefonit...*, derisa dëshmitari S. H., brenda të njëjtës periudhë kohore i ka telefonuar të ndjerës 177 herë. Nga ky numër i thirrjeve telefonike, vërtetohet fakti se në këtë kohë, tani e ndjera ka krijuar lidhje shumë të afërta dashurie me dëshmitarin S., dhe se komunikimi me të akuzuarin Xh., vjenë duke u rralluar. Po ashtu, afërsia e lidhja e fortë emocionale e tani të ndjerës me dëshmitarin S. H., vërtetohet edhe nga numri dhe përmbajtja e 53 mesazheve të nxjerrura nga SMS-ët, dhe atë prej datës 07.11.2012, deri më datën 03.12.2012, ora 06:09, të dërguara nga nr. *numri i telefonit...*, në numrin *numri i telefonit...*, të cilin e ka shfrytëzuar dëshmitari S., derisa të akuzuarit i ka dërgue vetëm 10 mesazhe, me përmbajtje shumë më të zbehtë të një lidhje emocionale.

Nga këto prova e fakte të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka vërtetuar tjera fakte shumë relevante për zbardhjen e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. I akuzuari Xh., në të gjitha fazat e procedurës ka deklaruar se i njëjti ka dashur të largohet dhe t'a braktisë tani të ndjerën, dhe në fakt sipas të njëjtit e ka braktisë dikund thotë 5-6 ditë e dikund 3-4 ditë para ngjarjes kritike, se e njëjta për këtë arsye edhe e ka fyer të akuzuarin, i ka dërgue shkresa në familje vetëm e vetëm për t'ia shkatërruar raportet familjare dhe bashkëshortore të të akuzuarit, se familja – bashkëshortja e të akuzuarit dhe djali kanë qenë të shqetësuar për këto shkresa, pastaj ka shtuar se tani e ndjera e ka ftuar të akuzuarin për t'a dërguar në punë shumë herë dhe atë thotë me telefon, herë duke i shkuar në shtëpi, e herë duke e lutur aman zaman, me arsyetimin se dikush po e përcjell, e që kësaj strategjie të mbrotjes, i akuzuari i ka qëndruar besnik deri në fund të gjykimit, dhe, edhe me rastin e ndërmarrjes së veprimeve mizore në L. të E., kur thotë se një njeri ka qëndruar 5 – 6 metra larg nga ai me rastin e goditjes me thikë të dëmtuarën, se edhe ditën kritike e ndjera ia ka kap timonin dhe ia ka drejtuar veturën në drejtim të fsh. Dumnicë, se me të arritur në vendin e shkakimit të krimit, e ndjera ka kërkuar të dalë jashtë veture për nevoja fiziologjike, dhe se ka rrëshqitur pastaj dikund poshtë dhe nga fyerjet e të ndjerës nuk ka mund t'i përballoj, dhe në këtë gjendje afektive mendore, edhe ka ndërmarrë veprimin e kundërligjshëm. Kjo Gjykatë, ka vlerësuar se, e tëra kjo mbrojtje e të akuzuarit, është e sajuar dhe imagjinatë e tij, dhe nuk është e bazuar në asnjë provë materiale a dëshmi personale, dhe se nuk ka asgjë të përbashkët me zhvillimin e vërtetë të kësaj ngjarje, për arsyet që do ipen si më poshtë.

Nga këto prova e dëshmi, nuk rezulton fare kontestuese se i akuzuari ka pasë lidhje dashurie me tani të ndjerën, mirëpo, nga provat materiale SMS-ët dhe dëshmia e dëshmitarit S., vërtetohet fakti se, e akuzuara në ndërkohë është njoftuar me dëshmitarin S. H., dhe duke qenë një lidhje e re, e njëjta është përpjekur në vazhdimësi të largohet nga i akuzuari, e jo e kundërta siç pretendon vet i akuzuari. Ky fakt vërtetohet nga numri i thirrjeve telefonike mes tyre, derisa i akuzuari e ka thirrë të ndjerën rreth 78 herë në telefon, e ndjera të akuzuarin e ka thirrë vetëm rreth 20 herë në telefon, ndërsa dëshmitarin S. e ndjera e ka thirrë rreth 54 herë, derisa dëshmitari S. e ka thirrë të ndjerën rreth 177 herë. Po ashtu, nëse analizohet përmbajtja e bisedave të nxjerrura nga komunikimet e tyre, krejt tjetër përmbajtje ka biseda e SMS-ët drejtuar S., e tjetër përmbajtje ka komunikimi me të akuzuarin. Këto prova, vërtetojnë pa kontestueshëm faktin se e ndjera ka dashur t'a përfundoj lidhjen e dashurisë me të akuzuarin. Nisur nga kjo gjendje e fakteve, e ndjera nuk ka pasur asnjë motiv për t'a shantazhuar, fyer e penguar në jetë të akuzuarin as me SMS e as me Letra dërguar në shtëpinë e tij. Kjo vërtetohet shumë bindshëm nga SMS-ët e shkëmbyera me të akuzuarin, ku e ndjera asnjëherë, asnjëherë nuk ka përdorë fjalë të ashpra apo fyese a vulgare kundër të akuzuarit, dhe edhe atëherë kur i akuzuari ka shprehë dyshim "formal" se ato letra po i dërgon H., nga këto SMS, rezulton se e ndjera i betohet të akuzuarit se e njëjta nuk ka fare lidhje me këto SMS-ët, duke i mallkuar personat që merren me këto punë, kjo vërtetohet nga SMS e të ndjerës të datës 22.11.2011 ora 12:55 min. I akuzuari vazhdimisht ka deklaruar se ka pranuar shumë letra të tilla, dhe të gjithë anëtarët e familjes kanë qenë të shqetësuar për këto letra, mirëpo nga dëshmia e bashkëshortes së tij, G. T., vërtetohet fakti se vetëm një letër e njëjta ia ka parë në dorë, mirëpo nuk e ka ditë çka është shkruar brenda, dhe asnjëherë nuk ka qenë e shqetësuar për këto gjëra dhe nuk ka pasur fare njohuri për këto gjëra, madje asnjëherë nuk e ka pyetur bashkëshortin e tij tani të akuzuarin, edhe për vonesat eventuale të kthimit të tij në shtëpi, ajo anjëherë nuk ka dyshuar në tradhëtinë bashkëshortore të të akuzuarit, pra pa kontestueshëm vërtetohet fakti se vetëm një letër mund t'i ketë dërguar të akuzuarit, e jo shumë letra, dhe atë jo e ndjera, por nëse ka ekzistue një letër e tillë, mund të jetë dërguar nga ndonjë person tjetër. Mirëpo, pikërisht nga frika se po e humb të dashurën e tij tani të ndjerën, i akuzuari ka filluar presionin dhe përcjelljen e të ndjerës, e edhe në punë me veturë. Këtë e vërteton dëshmia e dëshmitarit S. H., i cili e ka parë të ndjerën duke udhëtuar nga Vushtrria për në Prishtinë rregullisht me veturën e Xh.t, sepse në kohën kur e ndjera ka udhëtuar, dëshmitari ka zbrit prej autobusit në Vushtrri, dhe përveç kësaj, ky dëshmitar e ka përcjell të ndjerën dhe ka qenë i interesuar që të jetë në afërsi dhe kontakt me të njëjtën. Po ashtu, këtë fakt e ka pohuar edhe vet i akuzuari, ku ka deklaruar se shumë herë e ka dërguar në punë. Po ashtu, se vërtetë i akuzuari ka filluar t'i bëjë presion dhe t'i kanoset të ndjerës, këtë e vërteton edhe dëshmia e vajzës së të ndjerës, se Xh. e ka kërcënuar me fjalë duke i thënë se 'kom me të mbytë ty dhe qikën', po ashtu këtë fakt e dëshmon dëshmitari S., dhe vet e ndjera përmes SMS-ve të dërguara S., ku në vazhdimësi qarkullojnë bisedat mes tyre, ku e ndjera i tregon S. se ka

me mbyt të njëjtën dhe vajzën e saj, se e ndjera i ka thënë S. se "ajo po frikohet nga Xh. se ai ka me pre", e kështu me radhë. Bazuar në këto fakte dhe prova, gjykata vlerëson se nuk qëndron fare dhe nuk ka asnjë mbështetje faktike, pretendimi i mbrojtjes së të akuzuarit, se e ndjera e ka ftuar të akuzuarin t'a dërgoj në punë, përkundrazi, i akuzuari ka qenë ai që e ka penguar dhe përcjellë të ndjerën në punë, dhe atë shumë herë, edhe ditën kritike. Këtë e dëshmon dëshmitari S. i cili po thujse çdo ditë e ka përcjellë të ndjerën nga Stacioni i Autobusëve në Vushtrri dhe e ka vërejtur se i akuzuari po thujse çdo ditë po e shoqëron në punë, dhe po e pret me rastin e përfundimit të orarit të punës. Këtë fakt e vërteton edhe dita kritike, kur i akuzuari njëherë thotë se e ka thirrur me dërgue në punë, dhe në pyetjen se si e ka thirrur, pas një hezitimi, përgjigjet se ka ardhë te dritarja e shtëpisë, mirëpo nuk ka pritur por është larguar nga shtëpia e tij, dhe ky ka shkuar në mahallë të Gj., dhe e ka marrë të ndjerën. Se vërtetë i akuzuari nuk ka dashur të largohet nga tani e ndjera dhe e ka përcjellë edhe në vendin e punës dhe ka pritur derisa t'a përfundoj punën, kjo vërtetohet nga SMS-ët e të ndjerës drejtuar S., ku nga mesazhi i dt. 22.11.2012 ora 06:36 min., i thotë që në orët e mëngjesit, mos ma zilo telefonin nga frika se mos po e zënë i akuzuari, dhe po ashtu nga mesazhi i dt. 01.12.2012 ora 15:07 min., derisa e ndjera akoma është në vendin e punës, e ndjera i përgjërohet S. që mos t'a pret te vendi i punës, se është duke e pritur i akuzuari, duke i thënë "Posh ni zot mos ziljo se poshtë osht", nga se e njëjta është frikësuar shumë nga ballafaimi i të akuzuarit me S.. Po ashtu është e pa bazuar mbrojtja e të akuzuarit ku në seancën e shqyrtimit gjyqësor, në pyetjen se si është e mundur që ta kesh braktisë dhe të kërkoj nga Ju t'a përcjellni në punë të ndjerën dhe pse Ju keni pranuar, i njëjti përgjigjet se, i është lutur shumë me fjalët aman zaman. Ndërkaq, në ballafaqimin me deklarinimin e të akuzuarit se ditën kritike, e ndjera ka ardhë te shtëpia e të akuzuarit, se, pse një gjë të tillë nuk e keni përmend më parë, i njëjti përgjigjet "nuk mu ka jap e drejta" ?! Po ashtu, ditën kritike, me asnjë provë bindëse nuk vërtetohet fakti se e ndjera me të arritur te fsh. Stanovc, e ka kthyer timonin në drejtim të fsh. Dumnicë e L., përkundrazi, nga vet deklarata e të akuzuarit dhënë në Polici më datën 08.12.2012, ndër të tjera deklaroi, se "H. gjatë rrugës më kapi për fyti... në atë moment kam vendos me hi rrugës për në Breznicë", pra vet i akuzuari e ka kthyer veturën në atë drejtim. Dhe se, vërtetë askush nuk e ka përcjellë as të ndjerën dhe as të akuzuarin ditën kritike, këtë e dëshmon pikërisht kjo deklaratë e dhënë në Polici më datën 08.12.2012, ku i akuzuari asnjëherë nuk e ka përmend ndonjë rrethanë a fakt se dikush po i përcjell, por "për këtë rrethanë, i ka lind më vonë ideja", dhe po ashtu, edhe pas goditjeve me thikë dhe lënjen e braktisjen e të ndjerës në vendin e ngjarjes, nuk ka përmend asnjë person që ka qenë në afërsi dhe i ka shikuar në një distancë prej 5-6 metrash. Po ashtu nuk ka deklarua se ka dëgjuar asnjë fjalë fyese nga ana e të ndjerës, drejtuar të akuzuarit, derisa në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se me të arritur në fsh. L., i është drejtuar me fjalët "lahper, pis më ka sha me nënë etj", duke i thënë se "qitash ka me shkue te balldëska jote dhe ko mi treguu qishtu këtë gjendje si jam". Gjithashtu, deklarimi i të akuzuarit në seancë të shqyrtimit gjyqësor, se me të arritur në Fsh. L., tani e ndjera ka kërkuar të dalë nga vetura për nevoja fiziologjike dhe pastaj të dytë së bashku kanë rreshqitë poshtë në lumë, kjo mbrojtje është në kundërshtim të plotë me rrjedhën logjike të kësaj ngjarje, dhe me deklarinimin e vet të akuzuarit në polici, më datën 08.12.2012, atë ditë kur edhe është marrë për herë të parë në pyetje si i dyshuar, ku ndër të tjera ka deklaruar se "Unë kerrin e parkirata tek ni vend dhe i thashë hajde shkojna qatje poshtë e merrum vesh,...e kom nxjerrë briskun nga xhepi i djatht i jaknes me dorën e djathtë, dhe me dorën e djatht i kam ra H.s duke e mbajtur me dorën e majtë për jakne, dhe me dorën e djatht i kam ra...". Dhe në fund, po ashtu, për gjykatën nuk qëndrojnë pretendimet e të akuzuarit Xh. T., se tani të ndjerën pasi që e ka goditur disa herë me briskë, e ka lënë në vendin e ngjarjes dhe ka menduar se ndoshta personi që ka qenë me veturë të zezë në vendin e ngjarjes e ka dërguar në spital ku dhe ka pritur se mos dikush po e lajmëron nga spitali, e të cilin fakt, po ashtu nuk e ka përmend asnjëherë në deklaratën e dhënë në polici, por e vërteta është se nuk ka qenë asnjëri në afërsi gjatë zhvillimit të kësaj ngjarje, se i njëjti e ka lënë gjallë të ndjerën dhe ka dëshirue që të vuaj sa ma gjatë derisa të vdes duke e ditur se askush nuk mund t'a gjejë në atë vend, prandaj i akuzuari ka treguar pandjeshmëri ndaj dhimbjeve të mëdha dhe vuajtjeve të gjata të tani të ndjerës. Andaj gjykata ia fali besimin e plotë kësaj deklarate të të akuzuarit dhënë në prezencë të mbrojtësit të tij, për faktin se është dhënë për herë të parë dhe pas pak ditësh pas kësaj ngjarje, i akuzuari atëherë është deklaruar shumë hapur për zhvillimin e kësaj ngjarje, dhe ende nuk ka ndërtuar strategji të mbrojtjes, përkatësisht të përpjekjeve për shtrembërimin e fakteve, dhe kjo deklaratë është në përputhshmëri të plotë edhe me rrjedhën logjike të ngjarjes.

Gjykata ka bërë ndryshimin e përshkrimit të gjendjes faktike të kësaj çështje penale, meqenëse nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar një gjendje faktike tjetër nga ajo e përshkruar si në aktakuzë, kjo për faktin se me asnjë provë të vetme, nga të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, qoftë nga mesazhet, dëshmitarët, dhe nga deklaratat e vet të akuzuarit dhënë në polici, gjykata nuk ka arritë t'a vërtetoj faktin se, e ndjera e ka keqtrajtuar, fyer e shantazhuar të akuzuarin, se e njëjta ka dërguar shkresa në familjen e të akuzuarit, dhe se e njëjta ka qenë e interesuar për vazhdimin e lidhjes me të akuzuarin. Përkundrazi, kjo gjykatë në rigjykim, ka vërtetuar të kundërtën, se ka qenë vet i akuzuari ai i cili nuk ka dashur të largohet nga e ndjera, dhe se e tëra ka qenë imagjinatë e të akuzuarit, dhe natyrisht me qëllim të vetëm, të shmangjes nga përgjegjësia penale.

Andaj, bazuar në një gjendje të tillë të fakteve, dhe pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave materiale të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmitë e dëshmitarëve, dhe mbrojtjen e të akuzuarit Xh. T., gjykata vërtetoi se bazuar në mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale nga i akuzuari Xh. T., te i njëjti ka ekzistuar dashja direkte dhe këmbëngulësia e tij për kryerjen e veprës penale të vrasjes në mënyrë mizore, duke e goditur disa herë me thikë në pjesë të ndryshme të trupit tani të ndjerën, me qëllim që t'i shkaktoj dhimbje dhe vuajtje sa më të mëdha dhe të stërzgjatura tani të ndjerës derisa të vdesë, duke shpreh ndjenjat e tërbimit dhe hidhërimit të manifestuara me gjendje të pandjeshmërisë së tij ndaj tani të ndjerës, e duke qenë i vetëdijshëm se e njëjta është ende gjallë, ka ikë nga vendi i ngjarjes, e ka lënë të ndjerën në atë vend, duke e ditur se askush nuk mund t'a gjejë në atë vend, dhe e ndjera nuk mund të mbijetojë lëndimeve të shkaktuara nga i akuzuari, dhe pastaj të njëjtën ditë, rreth orës 9:30-10:00, shkon në lokalin e bashkëshortit të të ndjerës, pastaj në të njëjtën ditë nga telefoni i të ndjerës dhe në emër të saj, i shkruan SMS vajzës së të ndjerës G. T., duke e akuzuar një person të quajtur R., se kinse e ka marrë tani të ndjerën, e ka dërguar në Gjilan dhe po donë me mbyttë, kërkon t'a lajmërojë babanë dhe assesi policinë, ditën e nesërme shkon me bashkëshortin e tani të ndjerës në fshatin H., ku tani e ndjera ka punuar, gjëja se për të kërkuar të ndjerën, dhe tek pas pesë ditësh me dt.08.12.2012, pasi që është gjetë kufoma e të ndjerës, dhe marrjes në pyetje nga policia e Kosovës, i akuzuari i pranon veprimet e tij të goditjes me thikë të ndjerën, gjëja në afekt mendor. Për sa i përket përgjegjësisë penale të tani të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar se i njëjti është penalisht përgjegjës, bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të psikiatrisë Dr. F. D. dhe A. B., të cilët kanë konstatuar se i akuzuari në kohën e ndërmarrjes së këtij veprimi, ka pasur të zvogëluar llogaritshmërinë, por jo esencialisht të zvogëluar, shkallë kjo e cila do e dëmtonte gjykimin e tij për rëndësinë e veprës si dhe kontrollin e menaxhimit të veprimeve të tij.

Ashtu që bazuar në një gjendje të tillë të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë të kësaj çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e figures së veprës penale Vrasje e Rëndë nga neni 147 par. 3 të KPK-ës, në mungesë të rrethanave të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale, të njëjtin edhe e shpalli fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit Xh. T., i cili gjatë fazave të mëvonshme të zhvillimit të kësaj procedure penale i akuzuari ka ndryshuar deklaratat, duke dhënë deklaratat kundërthënëse në vetvete dhe kundërthënëse edhe me rrjedhën logjike të kësaj ngjarje kritike, si dhe me dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, këto deklaratat të të akuzuarit gjykata i ka vlerësuar si jo reale, jo bindëse dhe jo i sinqerta edhe në raport me tani të ndjerën, andaj ky qëndrim i të akuzuarit ka të bëjë vetëm e vetëm me qëllim të shmangjes nga përgjegjësia penale, andaj, Gjykata nuk e aprovoj mbrojtjen e ndryshuar të të akuzuarit Xh. T., duke konstatuar se mbrojtja e të njëjtit është e pabazuar, për faktin se deklaratat e tij ishin mjaft kontradiktore dhe në kundërshtim me njëra me tjetrën, si dhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit, av. O. M., se i mbrojturi i tij veprën penale e ka kryer në gjendje të afektit mendor, pa fajin e tij, nga shantazhimi, keqtrajtimi dhe fyerja e rëndë të cilën e ka pasur nga tani e ndjera H., mirëpo këto pretendime mbeten si të të tilla të pa bazuara në fakte dhe prova, që do e vërtetonin të kundërtën, nga se pikërisht nga provat e prezantuara

në shqyrtimin gjyqësor, me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fakti se tani e ndjera, e ka keqtrajtuar dhe fyer të akuzuarin, se njëjta nuk ka pasur as motiv për një gjë të tillë, këtë fakt edhe vet i akuzuari në deklaratën e parë të dhënë në polici, më datën 08.12.2012, asnjëherë nuk e ka përmend. Po ashtu, me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fakti se tani e ndjera, i ka bërë presion në familje duke i shkruar letra të cilat i kanë rënë në duart e djalit dhe bashkeshortës së Xh. T., me të cilat e ka kërcënuar dhe shantazhuar, se kjo ka qenë vetëm përpjekje për kamuflim të veprimeve të të akuzuarit, dhe përveq tjerash, këtë e ka vërtetuar dëshmia e bashkeshortës së vet të akuzuarit, se vetëm për një letër ka dëgjuar se ka ardhur në shtëpinë e tyre, se atë letër nuk e ka parë dhe nuk ka ditur se çka ka shkruar në atë letër, dhe për më tepër asnjëherë nuk ka përmend faktin se kjo letër e ka shqetësuar të njëjtën dhe se ka qenë shkak për prishjen e raporteve bashkëshortore me të akuzuarin. Andaj, të gjitha këto fakte dhe prova, dëshmojnë pa kontestueshëm faktin se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale në një gjendje të afektit mendor, dhe se për këtë veprë penale, i akuzuari është penalisht përgjegjës, bazuar edhe në mendimin e konstatimit të ekspertëve psikiatrik.

Me rastin e vlerësimit të cilat ndikojnë në përcaktimit e llojit dhe lartësisë së dënimit, në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese, të kaluarën e të akuzuarit, rrethanat sociale, nivelin e ultë të arsimit, padënueshmërinë e tij të mëparme, dhe gjendjen e varfër materiale, ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, këmbëngulësi dhe vendosmërinë për kryerjen e kësaj veprë penale, viktimat tani e ndjera ka qenë e pa mbrojtur duke qenë fizikisht më e dobët se i akuzuari, dhe intensitetin e lartë të rrezikimit të vlerave të mbrojtura siç është jeta e njeriut. Duke i vlerësuar në këtë mënyrë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kjo gjykatë, kjo gjykatë ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e të njëjtit, si dhe do të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga nenit 34 të KPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marr konform nenit 73 par.1 të KPK-së, dhe të njëjtit me aktvendim të veçantë, i është vazhduar paraburgimi, i cili mund të zgjasë deri në plotëfuqishmëri të këtij aktgjykimi, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykim, konform nenit 367 par.6 dhe 7 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, përkatësisht faktit se kemi të bëjmë me veprë penale Vrasje e rëndë, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale, ku në këtë çështje janë mbajtur shumë seanca gjyqësore, si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, përkatësisht faktit se i njëjti jeton në kushte të rënda ekonomike, konform nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike në kontest të rregullt civil, është marrë pasi që pala e dëmtuar nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, dhe duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.217/2016 me dt.15.07.2016

Procesmbajtësja

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari

Mybera Latifi

Beqir Kalludra

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
Gjykatës Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditë,
nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate.